

VENDIM
Nr.587, datë 27.4.2007

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
PRIVAT “APT”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të KKRT-së nr.421, datë 27.2.2006, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.21, datë 30.3.2004, ndryshuar me vendimin nr.503, datë 17.7.2006, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për zgjerimin e zonës së licencimit për televizionin kabllor privat “APT” me nr.licence 039/RTVK në qytetet e Sarandës dhe të Pukës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku